



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 307, datë 18.12.2019

PËR
TRANSFERIMIN E GJYQTARIT Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1, nenin 147/a, shkronja “a” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 44, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 162, pikat 1, 3 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi relacionin përkatës dhe materialet e nevojshme, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I :

1. Transferimin e gjyqtarit/es të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda z. {...}, pranë Gjykatës së Apelit Korçë, duke filluar nga data 19.12.2019 dhe deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit sipas Ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
2. Në rast të konfirmimit në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, gjyqtari z. {...} gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion, që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve, në gjykatat e apelit me juridiksionin të përgjithshëm.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Apelit Korçë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR